

---

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“VICTORIA HYDROENERGY” SHPK**

**THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA**

**Neni 1  
Ortakët themelues**

Sot më datë 28.08.2017 Ortakët Themelues të shoqërisë:

1. Shoqëria “VICTORIA INVEST INTERNATIONAL” sh.p.k. me numer regjistrimi biznesi NRB 70038606, me seli kryesore ne Brigada 123 Suhareke Kosove, dhe me degë e shoqerise huaj, regjistruar prane QKB me nr. NIPT-i, “L02712202J”, me ortak te vetem dhe perfaqësues ligor z FATMIR KUÇI me datelindje 15.03.1972, i identifikuar me leternjoftim nr. 028450811, me numer personal H20315332K , madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar .
2. Shoqëria “VICTORIA INVEST” Sh.p.k., person juridik shqiptar i regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me nr.NIPT-i, “K32712206U” e përfaqësuar nga Administratori Ligor i Shoqërisë: Z. FATMIR KUÇI me datelindje 15.03.1972, i identifikuar me leternjoftim nr. 028450811, me numer personal H20315332K, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar .

Hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “VICTORIA HYDROENERGY” sh.p.k., mbështetur ne ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtaret dhe shoqeritë tregtare”(ndryshuar), Ligji Nr. 125/2013 “Për Koncessionet dhe Partneritetin Publik Privat” (ndryshuar), ligjin 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, dhe çdo dispozitë tjeter të zbatueshme të legjislacionit shqiptar, si me poshte:

**Neni 2  
Forma Ligjore e Shoqërisë**

- 2.1 Shoqeria “VICTORIA HYDROENERGY” sh.p.k është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me perqësjesi te kufizuar (me poshte referuar “Shoqëria”).
- 2.2 Shoqëria “VICTORIA HYDROENERGY” sh.p.k është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortakët e shoqërisë”, të cilët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakeve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
- 2.3 Ortaket gjëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

**Neni 3  
Kohëzgjatja e Veprimtarisë**



---

1.1 Shoqëria kriohet për të vepruar për gjithë kohën e përcaktuar në Kontratën e Koncensionit, e cila eshte 35 vjet duke filluar nga data e themelimit te saj .

**Neni 4**  
**Selia/Adresa e Regjistruar**

- 4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën : Rr."11 Nentori", Lagjia 28 Nentori, zona kadastrale 8523, pasuria 8/340 – N.15, kati II, Elbasan , Shqipëri.
- 4.2 Administratori mund të krijojë NIPT-e sekondare të Shoqërisë.

**Neni 5**  
**Objekti**

5.1 Objekti kryesor i Shoqërisë është:

- Ndertimi i Hidrocentraleve mbi Lumin e Zallit te Lunik, te tipit BOT, (Ndërto-Opero-Transfero);
- Prodhimi, tranzmetimi dhe shitja e energjisë elektrike të prodhuar nga HEC mbi Lumin e Zallit te Lunik .
- Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e Hec-it si më sipër gjatë periudhës koncesionare.

**Neni 6**  
**Kapitali**

**Kapitali themeltar**

6.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 10.000 (*dhjetë mijë*) Lekë.

6.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 2 kuota :

6.3 Kuotat do të zoterohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:

- c. **Shoqëria "VICTORIA INVEST INTERNATIONAL" sh.p.k.**, zotërues i një kuote me vlerë te per gjithshme 6.000 (*gjashtë mijë*) Leke, qe perben 60 % të kapitalit të Shoqërisë;
- d. **Shoqëria "VICTORIA INVEST" Sh.p.k.**, zotërues i një kuote me vlerë te per gjithshme 4.000 (*kater mijë*) Leke, qe perben 40 % të kapitalit të Shoqërisë;

**STRUKTURA DREJTUESE**

**Neni 7**  
**Asambleja e Ortakëve**

7.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

---

7.2 Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve (“Asambleja e Ortakëve”), të drejtën për të zgjedhu: dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese , të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.

7.3 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
- c. të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të Shoqërisë;
- d. miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- e. të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
- f. vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
- g. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- h. të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
- i. të miratojë raportet vjetore dhe bilancet dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë;
- l. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë ;
- m. të vendosë pagën e Administratorit;
- n. të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- o. të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
- p. të vendosë mbi buxhetin vjetor;
- q. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- r. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- s. të vendosë marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria;
- t. të vendosë pér çdo çështje tjetër, që i takon pér zgjdhje asamblesë së ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.


Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jebet vetëm pér një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

## Neni 8 Vendimet e miratuara në Asamblenë e Ortakëve, Kuorumi


8.1 Në rastin e vendimeve të miratuara me Shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët me të drejtë vote që kanë më shumë se 30% të kuotave të nënshkruara.



- 
- 8.2 Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë Shumicë të kualifikuar, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
- 8.3 Nëse Asambleja e Ortakëve është e mbledhur në mënyrë korrekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, asambleja e ortakëve do të mblidhet sërisht në përputhje me parashikimet e Nenit 14 te Statutit por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës i asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.
- 8.4 Kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk është thirrur sipas formalitetave të ligjit ose këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullisë.
- 8.5 Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që ai të formalizohet me shkrim.
- 8.6 Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

### **Neni 9** **Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve**

- 9.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postë elektronike të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar.
- 9.2 Asambleja e përgjithshme thirret nga Administratori edhe nëse,
- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 9.3 Më tej, anëtarët që përfaqësojnë të paktën 5% të votave të përgjithshme të Shoqërisë mund t'i kërkojnë administratorit me shkrim apo me postë elektronike thirrjen e asamblesë së ortakëve. Kërkesa duhet të mbajë arsyet dhe objektivat dhe çështjet për të cilat asambleja e ortakëve duhet të vendosë.
- 9.4 Asambleja e Ortakëve do të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga administratori, i cili duhet t'u dërgohet përfaqësuesve të ortakëve me letër rekomande ose faks ose postë



- 
- elektronike (e-mail) jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpëra ditës së caktuar për asamblenë Njoftimi për ortakët duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes së asamblesë si dhe çështjet për t'u diskutuar (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambieje të zakonshme të ortakëve, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.
- 9.5 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjeter në përputhje me nenin 85 të Ligji të Shoqërisë Tregtare.

### **Neni 10** **Administrimi i Shoqërisë dhe kompetencat e administratorit**

- 10.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator i vetëm, i emëruar në përputhje me këtë statut.
- 10.2 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumice të Zakonshme. Në asnjë rast ortakëve nuk i duhet të justifikojnë apo provojnë se cilat janë shkaqet për të cilat ata shkarkojnë administratorin. Në cdo rast janë ortakët ata të cilët vlerësojnë se ka shkaqe të arsyeshme për shkarkimin e administratorit
- 10.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbyshur qëllimin e shoqërisë, me përashtimi të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizoje paletë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

- 10.4 Personi i mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat 5 vjeçar:
- z. **Endri Kuçi**, i datelindjes 03.06.1977, i identifikuar me leternjoftim nr.030884507, me numer personal H70603205H, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar, me specimen nënshkrimi \_\_\_\_\_
- z. Dorian Molloholli, i datelindjes 18.01.1980, i identifikuar me leternjoftim nr.032800349, me numer personal I00118056A, madhor me zotesi te plete juridike per te vepruar, me specimen nënshkrimi \_\_\_\_\_

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërisë Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

- 10.5 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
  - hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
  - përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave, pas miratimit me shkrim nga ortaket;

- 
- d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palet e treta;
  - e. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
  - g. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit, pas miratimit me shkrim nga ortaket;
  - h. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
  - i. administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i térheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të myllë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të térheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në cdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërmë, administratori duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
  - j. ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
  - k. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
  - l. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
  - m. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së përgjithshme të Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
  - n. të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata të tjera financiare, fletëparaqitjet tative të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
  - o. Administratori është i detyruar të therrasë asamblenë e përgjithshme të Ortakëve në rastet kur:
    - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston treziku qe aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
    - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyre tjetër aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

- 
- shocjëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - p. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënata e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin pér Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - q. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente pérpara asamblesë së përgjithshme pér miratim;
  - r. çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.

### **Neni 11 Viti Financiar dhe Dividendi**

- 11.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Përashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt më datë 31 Dhjetor.
- 11.2 Pas përcaktimit të fitimit të Shoqërisë në përputhje me pasqyrat financiare dhe pas përbushjes së kërkeseve së nenit 77 të Ligjit pér Shoqëritë Tregtare, fitimi i Shoqërisë, deri sa të shlyhet shuma e investimit filletar, ndahet midis ortakëve sipas përqindjes së tyre në shoqëri.

### **Neni 12 Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan .

### **Neni 13 Dispozita përfundimtare**


Ky akt themelimi u redaktua në 4 ekzemplarë me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nen pér nen nga Ortakët e shoqërisë tregtare “**VICTORIA HYDROENERGY** sh.p.k nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“VICTORIA HYDROENERGY” sh.p.k.**


**“VICTORIA INVEST INTERNATIONAL” sh.p.k.**

**“VICTORIA INVEST” Sh.p.k.**

**Z. FATMIR KUÇI**



**Z. FATMIR KUÇI**



20